


Për:	Zyrën e Rregullatorit të Energjisë
Nga:	Valdete Marevci-Dërmaku - Koordinator e Ndërmarrës me Institucione tjera
Përmes:	Fisnik Osmani - Kryeshef Ekzekutiv i NP "Termokos" SH.A Prishtinë
Data:	18.09.2023
Subjekti:	Raportimi Rregullativ i N.P "Termokos" Sh.A. në kuadër të aplikimit për shqyrtim tarifor për sezonin ngrohës 2023/2024

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin 2023/2024, ju përcjellim të bashkangjitura këto raporte:

1. Pasqyrat Rregulative me të dhënat e parashikuara për periudhën (15 tetor 2023-15 tetor 2024),
2. Shpalosja e Pasqyrës B,
3. Raportet e detajuara, në kuadër të aplikimit për shqyrtimin tarifor për sezonin ngrohës 2023/2024, të cilat përmbajnë:
 - a. Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrahatoren qendrore të NP "Termokos" SH.A,
 - b. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë ,
 - c. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve,
 - d. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik ,
 - e. Planifikimi i kyçjeve të reja,
 - f. Planifikimi i investimeve me vetfinancim dhe nga donacionet.
4. Përgjigjet e NP "Termokos" sh.a në komentet e dhëna nga ZRRE, në Aplikacionin për tarifa për sezonin 2023/2024,
5. Raport me informacione plotësuese lidhur me projektet zhvillimore të NP "Termokos" SH.A , të paraqitura në aplikacionin tarifor për sezonin 2023/2024,
6. Studimi i fizibilitetit për projektin "Solar4 Kosova II " (është dorëzuar përmes USB me dt. 06.09.'23),
7. Studimi i ndikimit në mjedis dhe social për projektin "Solar4 Kosova II " (është dorëzuar përmes USB me dt. 06.09.'23),


 Nr. 477123
 Data 20.09.23

8. Plani I dekarbonizimit , Për projektin "Dyfishimi I kapaciteteve prodhuese termike" "(është dorëzuar përmes USB me dt. 06.09.'23),
9. Marrëveshjen në mes Bankës Europiane për Investime , Ministrisë së Financave dhe NP "Termokos "sh. A.- për projektin "Dyfishimi I kapaciteteve prodhuese termike"(është dorëzuar përmes USB me dt. 06.09.'23),
10. Pjesën e kontratës me Informatat kryesore për ndërtimin e objektit të ri administrativ.



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

NDËRMARRJA PUBLIKE PUBLIC ENTERPRISE-JAVNO PREDUZEĆE

TERMOKOS S.H.A.
D.D.

PRISHTINE-PRISHTINA-PRISTINA

Nr 1844/1 Dt 20.09 2023

Raportimi Rregullativ I Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore

Shtojca Nr.1

PASQYRAT (DEKLARATAT) RREGULLATIVE

Planifikimet - Sezona 2023/2024



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raportimi Rregullativ - Planifikimi - Sezoni 2023-2024

Ndërmarrja:

N.P."Termokos"Sh.A

Periudha:

15.10.2023-15.10.2024

Pasqyra A - G1, G2 : Pasqyra e Aseteve Operative

Asetet Drejtëpërdrejt të Përcaktuara				Asetet Mbështetëse	Asetet e nërbashkëta	Në Euro	
Prodhimi i ngrohjes		Distribulimi dhe furnizimi i ngrohjes		e	f	Totali i Aseteve	
a	c	d				g	
1	Çmimi i blerjes me koston historike	5,222,836.22	69,717,230.98		4,741,073.73	79,881,140.93	
2	Zhvlerësimi i akumuluar	4,348,397.73	22,640,184.82		577,770.74	27,566,363.29	
3	Vlera sipas librave kontabël	874,438.49	47,077,046.16		4,163,302.99	52,114,787.64	
4	Çmimi zavendësues në vlerën e tregut					0.00	

Aprovuar nga:

EMRI e MBIEMRI / Pozita

Artan Shabani- ZKFTH

Nënshkrimi:

Fisnik Osmani - Kryeshf/Ekzef

Nënshkrimi:

Data : 09.08.2023

Punuar nga:

EMRI e MBIEMRI / Pozita

Edil Ajvazi - Koordinator për thesat dhe

Nënshkrimi:

Nënshkrimi:

Data : 09.08.2023





Raportimi Rregullativ - Planifikimi - Sezoni 2023-2024

Ndërmarrja: **NP" Termokos "sh.a**

Periudha: **15.10.2023-15.10.2024**

Pasqyra B - G1, G2 : Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Në Euro

		Drejtëpërdrejt të Përcaktuara		Mbështetëse	Të Përbashkëta	Total
		Prodhimi i Ngrohjes	Distribuimi dhe Furnizimi i ngrohjes			
	a	c	d	e	f	g
1	Të Ardhurat e lejuara					
2	Të ardhurat nga shitja e ngrohjes					9,553,701.48
3	Të ardhurat tjera të lejuara					130,000.00
4	Totali i të ardhurave të lejuara					9,683,701.48
5	Shpenzimet e lejuara					
6	Shpenzimet Operacionale					
	Shpenzimet variabile :					
7	Energjia termike nga kogjenerimi					1,586,790.20
8	Karburanti					490,904.44
9	Uji i trajtuar					64,000.00
10	Kemikalet për trajtimin e ujit					72,800.00
11	Elektriciteti					835,000.00
12	Shpenzimet e Personelit (puna direkte ne prodhim)					1,423,643.45
13	Shpenzimet tjera variabile					143,716.30
14	Totali i shpenzimeve variabile					4,616,854.39
15	Shpenzimet fikse					
16	Riparimet dhe mirëmbajtja					134,300.00
17	Materialet dhe shërbimet					90,000.00
18	Shpenzimet për administratë					156,000.00
19	Shpenzimet e personelit					1,458,516.92
20	Shpenzimet e Shitjes dhe tjera Administrative					
21	Totali i shpenzimeve fikse					2,049,260.24
22	Totali i shpenzimeve operative					6,666,114.62
23	Zhvlerësimi					2,996,113.69
24	Totali (Shpenz. operative + Zhvlerësimi)					9,662,228.31

iqarim: Vlera e shpenzimit të energjisë elektrike shtë planifikuar 835,000€, për shkak se përveç gritjes së shpenzimit të energjisë elektrike në 1Wh, në këtë sezonë ka edhe ngritje të çmimit të nergjisë elektrike për 15.5%.

Aprovuar nga:

EMRI e MBIEMRI / Pozita

Arton Shabani- ZKFTH

Nënshkrimi:

Fisnik Osmani - Kryeshk. Ekzekutiv

Nënshkrimi:

Data :09.08.2023

Punuar nga:

EMRI e MBIEMRI / Pozita

Abil Ajvazi - Koordinator për
financiar dhe raportim financiar

Nënshkrimi:

Data :09.08.2023





Raportimi Rregullativ - Planifikimi- Sezoni 2023/2024

NP" Termokos "sh.a

Periodha: 15.10.2023-30.04.2024

Pasqyra C-G2 : Pasqyra e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave

Faturimi me matje - sipas konsumit të matur										
	Sip. Ngrohëse [m2]	Kapac. Termik [kW]	Kons. i En. Term. [MW/h]	Faturimi për kapac. [EUR]	Faturimi për energji [EURO]	Total faturimi [EURO]	Arkëtimi [EURO]	Arkëtimi [%]	Borxhi [EURO]	Borxhi [%]
1	449,900.05	573,551.48	67,987.88	446,477.14	2,461,528.06	2,908,005.20	2,670,000.00	91.82	238,005.20	8.18
Faturimi pa matje - sipas sipërfaqjes ngrohëse										
	Grupi i konsumatorëve		Sipërfaqja Ngrohëse [m2]		Faturuar [Euro]	Arkëtuar [Euro]	Shkalla e Arkët. [%]	Borgji [Euro]	Borgji [%]	
2	Shtëpijak (Amvisiri)		1,283,099.61		5,558,387.51	4,420,000.00	79.52	1,138,387.51	20.48	
3	Komerical dhe Institucional		200,795.71		1,087,308.77	825,000.00	75.88	262,308.77	24.12	
4	Total		1,933,795.37		6,645,696.28	5,245,000.00	78.92	1,400,696.28	21.08	
5	Total (me matje + pa matje) [EURO]				9,653,701.48	7,915,000.00	82.85	1,638,701.48	17.16	

Aprovar na prova: **Puntuar na:**

EMÉRI, MBIEMÉRI/Pozita

Fisnik Osmani - Kryetar Ekzekutiv
Raif Vito - Drejtor i Furnizimit

NENSHKRIMTAKTINENS KRIM


 Data: 08.08.2023
 Data: 07.08.2023

Punuar nga:

EMERGENCY BIOMERIT/Posita

Raif Vitić - Drejtor i Furnizimit

WENDE KRIMI

Date: 09.08.2023



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raportimi Rregullativ - Planifikimi Sezoni 2023/2024

Ndërmarrja

N.P."Termokos"Sh.A

Periudha:

15.10.2023-15.10.2024

Pasqyra D-G1, G2-Pasqyra e shpenzimeve të investimit -aktuale dhe e planifikuar

Në euro

	a	Aktuale -viti 0 (15 tetor 2023 -15 tetor 2024)	Planifikuar - viti 1 2025	Planifikuar - viti 2 2026	Planifikuar - viti 3 2027	Planifikuar - viti 4 2028
1	Periudha					
1	Prodhimi i ngrohjes	731,000.00	323,795.00	339,984.00	356,983.00	374,832.00
2	Distribuidi i ngrohjes	340,000.00	350,000.00	320,000.00	310,000.00	300,000.00
3	Tjera -Administrata dhe Investimet e përbashkëta për të gjitha departamentet	2,503,000.00	4,000,000.00	4,000,000.00	5,000,000.00	5,500,000.00
4	Bashkfinancim për projektet zhvillimore	8,254,139.00				
5	Totali i investimeve me vetëfinancim	11,828,139.00	4,673,795.00	4,659,984.00	5,666,983.00	6,174,832.00
6	Donacionet	15,384,372.00	22,000,000.00	45,000,000.00	50,000,000.00	60,000,000.00
7	Grand Total	27,212,511.00	26,673,795.00	49,659,984.00	55,666,983.00	66,174,832.00

Aprovuar nga :

EMERI, MBIEMERI/Pozita

Fisnik Osmani : Kryeshef Ekzekutiv

Nënshkrimi:

Punuar nga:

EMERI, MBIEMERI/Pozita

Fisnik Bytyçi-Drejtor i Distributimit

Nënshkrimi:

Fisnik Hoxha - Drejtor i Prodhimit

Nënshkrimi:

Data:09.08.2023

Termokos

Data:09.08.2023

PRISHINË



Raportimi Rregullativ - Planifikimi - Sezoni 2023/2024

Ndërmarrja:

N.P"Termokos"Sh.A

Periodha:

15.10.2023-15.04.2024

Pasqyra E - G1, G2 - Pasqyra Teknike

Të dhënat e përgjithshme teknike

1	Kapaciteti i instaluar i energjisë termike (ngrohjes) në ngrohore	MW	135.60
2	Kapaciteti i instaluar i energjisë termike nga kogjenerimi	MW	140.00
3	Kapaciteti i disponueshëm i energjisë termike (ngrohjes) në ngrohore	MW	134.00
4	Kapaciteti i disponueshëm i energjisë termike (ngrohjes) nga kogjenerimi	MW	140.00
5	Gjatësia e rrjetit të transportit të en. term. KEK-Termokos	km	11.50
6	Gjatësia e rrjetit të distribuimit	km	110
7	Numri i nënstacioneve	-	900
8	Numri i nënstacioneve aktive	-	880

Bilanci i energjisë termike /Prodhimi/

6	Energjia e futur nga karburanti	MWh	0.00
7	Prodhimi bruto i ngrohjes në ngrohore	MWh	-
8	Sasia e energjisë termike nga kogjenerimi	MWh	342,327.04
9	Humbjet në rrjetin e transportit	MWh	6,847.00
10	Konsumi vetanak	MWh	860.00
11	Prodhimi neto i energjisë termike (ngrohjes)	MWh	334,620.04
12	Efikasiteti total i energjisë termike	%	97.75
13	Konsumi i ujit	m3	80,000
14	Konsumi i elektricitetit	MWh	9,430.00

Bilanci i energjisë termike /shpërndarja e furnizimi/

13	Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit (e matur)	MWh	334,620.04
14	Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje (e matur)	MWh	307,851.00
15	Humbjet e distribuimit	MWh	26,770.00
16	Humbjet e distribuimit në përqindje	%	8.00

Të dhënat për konsumatorë

Të dhënat për konsumatorë			Konsumatorët Shtëpijak	Konsumatorët Komerical dhe Institucional	Totali / Mesatare
17	Kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes	MW	128,309.96	78,083.49	206,393.45
18	Totali i sipërfaqes së ngrohur	m2	1,283,099.61	650,695.76	1,933,795.37
19	Kërkesa specifike për kapacitetin e ngrohjes	W/m2	100.00	120.00	110
20	Orët e ngarkesës së plotë	h	1,500.00	1,500.00	1500
21	Kërkesa për ngrohje (furnizimi me ngrohje i kalkuluar)	MWh	192,464.94	117,125.24	309,590.18

Konsumi i karburantit

		Sasia tona	Vlera (LHV) MWh/t	Energjia në karburant MWh
22	Nafta e rëndë (mazuti)	0.00	11.30	0.00
23	Nafta e lehtë (diesel D2)			0.00

Sqarim: Shpenzimi i energjisë elektrike është planifikuar 9,430MWh, bazuar në ritjen e numrit të nënstacioneve dhe një pompë shtesë për rrjetin e distribuimit.



Aprovuar nga:

EMRI e MBIEMRI / Pozita

Planik Osmani - Kryeshef

Ekzekutiv

Nënshkrimi:

Data: 09.08.2023

Punuar nga:

EMRI e MBIEMRI / Pozita

Nain Bytyci - Drejtor i Distribuimit

Nënshkrimi: [Signature]

Florent Hoxha - Drejtor i Prodhimit

Nënshkrimi: [Signature]

Nënshkrimi:

Data: 09.08.2023

Raportet e detajizuara në kuadër të Aplikimit për shqyrtim tarifor për sezonin ngrohës 2023/2024

Të nderuar,

N.P."Termokos"SH.a, ka përgaditur dokumentacionin, raportet me të dhëna dhe informatat e kërkuara nga ZRRE në kërkesën e datës 7.06.2023, në lidhje me fillimin e shqyrtimit të tarifave të energjisë termike për sezonin 2023/2024.

Përveç Pasqyrave Rregullative të plotësuar me të dhëna të planifikuara, Shpalosjes së Pasqyrës B (të cilat ua dërgojmë si dokumente të bashkangjitura) , në këtë dokument janë dhënë edhe detajizime e shpjegime përkatëse që përmbajnë të dhënat e parashikuara për periudhën 15 tetor 2023 – 15 tetor 2024, që përfshinë sezonin e ardhshëm të ngrohjes 2023/2024.

Bazuar në kërkesën në fjalë, në këtë dokument janë paraqitur :

1. Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B dhe në ngrohoren qëndrore të NP "Termokos"SH.A

1.1 Detaje për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B

- Në tabelën 1. është paraqitur energjia termike e planifikuar dhe kostoja e energjisë termike për sezonin 2023/24. Vlerësimi është bërë bazuar në kapacitetin e deklaruar dhe energjinë termike e cila derivon nga ky kapacitet (Kapaciteti x 6.56), ndërsa nuk është përfshirë TVSH. Në kosto është llogaritur edhe Taksa e Licencës për Energjinë Termike. Kalkulimi i koston së energjisë termike është bërë duke u bazuar në çmimin për kapacitet, energji termike dhe Taksa së Licencës për energjinë termike, të aplikuarat gjatë sezonit 2022/2023.

**** Plani për vitin 2024 ende nuk është aprovuar nga KOST dhe MEI**

PLANIFIKIMI PËR SEZONIN 2023/2024			
Sezona 2023/2024			
	Kapaciteti i deklaruar MWh/h	Energjia MWh TER	Vlera e faturës pa TVSH/€
Tetor 2023	3,085.00	20,237.60	93,807.45
Nentor 2023	8,068.00	52,926.08	245,328.52
Dhjetor 2023	9,967.00	65,383.52	303,072.55
Janar 2024	10,964.00	71,923.84	333,388.93
Shkurt 2024	8,875.00	58,220.00	269,867.45
Mars 2024	8,223.00	53,942.88	250,041.69
Prill 2024	3,002.00	19,693.12	91,283.62
Total :	52,184.00	342,327.04	1,586,790.20

Tabela 1. Energjia termike e planifikuar për sezonin ngrohës 2023/2024

1.2 Planifikimi i prodhimit të energjisë termike nga stabilimentet e prodhimit në ngrohtore

- Aktualisht sasia bruto e mazutit në të katër rezervuarët është 855 ton, kurse sasia neto (të shfrytëzueshme) janë 695 ton.



Termokos

Ngrohja e qytetit

- Për sezonin 2023/2024, në rast të ndonjë pengese për furnizim me energji termike nga termocentrali "Kosova B", planifikohet që furnizimi me ngrohje të bëhet nga stabilimentet e prodhimit të energjisë termike në ngrohore.
- Për këtë qëllim janë planifikuar të shpenzohen 695 ton mazut, që mjaftojnë për furnizim në kohëzgjatje prej rreth 10 ditësh, duke shpenzuar mesatarisht rreth 70 ton mazut në ditë.

Sqarim:

Licenca e Prodhimit të Energjisë termike të NQ Termokos, ka skaduar në fillim të tetorit 2021, dhe në kuadër të plotësimit të kushteve për vazhdimin e kësaj licence nga ZRRF, është pajisja me Leje Mjedisore.

Lidhur me këtë, nga MMPHI është lëshuar Vendimi për Përqim Mjedisor për NP "Termokos" SHA me datë 27.06.2022, ndërsa (sij) ju kemi informuar edhe më parë) lidhur me kërkesën e dt. 15.10.2021, ku NQ Termokos ka kërkuar nga MMPHI lirin nga obligimi i sigurimit të Lejes mjedisore, zyrtarët e MMPHI n'a kanë informuar se nuk kanë bazë ligjore për një veprim të tillë, andaj nuk mund të n'a lirojnë nga ky kusht. Prandaj kemi qenë të obliguar që të ndjekim procedurat e parapara sipas ligjeve përkatëse për t'u pajisur me Leje Mjedisore të integruar.

Bazuar në sa u tha më lartë, me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leje Mjedisore të integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI), ku janë dërguar Aplikacioni i plotësuar dhe dokumentet mbështetëse.

Pas kësaj, mbështetur në kërkesën e MMPHI të datës 09.09.22, dhe kërkesave plotësuese nga zyrtarët e MMPHI nga takimet konsultative të përbashkëta, me datë 08.12.2022 dhe 11.05.2023, kemi dërguar dokumentacionet plotësuese dhe riplotësimin e pikave të Aplikacionit, në të cilin, ndër të tjera është dërguar edhe "Raporti i matjeve të emisjonit të gazrave djegëse dhe të pluhurit" nga Enti i hulumtimeve "INKOS" Sh.A, sipas matjeve të datës 02.02.2023 në ngrohoren qendrore Termokos.

Duke vlerësuar se janë plotësuar kriteret dhe dokumentacionet e kërkuara nga MMPHI, jemi në pritje të vendimeve të MMPHI për lëshimin e "Lejes Mjedisore të integruar", për të cilën shpresojmë se do të marrim përgjigje para fillimit të sezonit ngrohës 2023/2024.

2. Planifikimi i sasisë së energjisë së liferuar te konsumatorët dhe humbjet e energjisë në sezonin 2023/2024

Në tabelën 2. është pasqyruar planifikimi për furnizimin e konsumatorëve me energji termike / ngrohje, si dhe humbjet në rrjetin e transportit (TTC Kosova B-NQ Termokos), vetkonsumi dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në këtë tabelë nuk është përfshirë planifikimi i prodhimit të energjisë në ngrohore, pasi që ajo planifikohet vetëm për rastet emergjente.

PLANIFIKIMI I SASISË SË ENERGISË DHE HUMBJEVE PËR SEZONIN 2023/2024										
Sezona 2023/2024										
	Kapaciteti i deklaruar	Energjia termike	Energjia termike e pranuar nga KEK	Humbjet e energjisë në rrjetin e transportit	Konsumi vetanak	Energjia neto e futur në rrjetin e shpërndarjes	Energjia e liferuar te konsumatorët	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes	Humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes	
	MW/h/h	MW/h TER	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	MW/h	%
Tetor 2023	3,085	20,238	19,833	405	68	19,765	18,184	1,581		
Nentor 2023	8,068	52,926	51,868	1,059	115	51,753	47,612	4,140		
Dhjetor 2023	9,967	65,384	64,076	1,308	140	63,936	58,821	5,115		
Janar 2024	10,964	71,924	70,485	1,438	163	70,322	64,697	5,626		
Shkurt 2024	8,875	58,220	57,056	1,164	145	56,911	52,358	4,553		
Mars 2024	8,223	53,943	52,864	1,079	127	52,737	48,518	4,219		
Prill 2024	3,002	19,693	19,299	394	102	19,197	17,661	1,536		
Total :	52,184	342,327	335,480	6,847	860	334,620	307,851	26,770		8.0

Tabela2. Planifikimi i energjisë termike dhe humbjeve në rrjetin e transportit të energjisë dhe rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

➤ Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë është planifikuar të jenë 2%, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8%.

Sqarim :

Humbljet e energjisë (ujit) në rrjetin e shpërndarjes janë planifikuar 8%, pjesa më e madhe e këtyre humbjeve i referohet mbushjeve me ujë të trajtuar të rrjetit sekondar në objektet e reja dhe në objektet e vjetra, aty ku janë duke u instaluar nënstationet e reja.

Me projektin e KfW do të kryen edhe shumë objekte të reja në kuadër të zgjerimit dhe dendësimit të rrjetit, në lagjen Mati 1, Arbëria, Qendër te Parku i qytetit, rrjeti sekondar i të cilave mbushet vetëm nga rrjeti primarë. Gjithashtu ndikojnë edhe rrjedhjet në segmente të caktuara të rrjetit, të cilat ende nuk janë rehabilituar.

Andaj, elementet që ndikojnë në këtë nivel të parashikimit të humbjeve të energjisë (ujit) janë:

- Zgjerimi i rrjetit primarë,
- Pjesa sekondare e objekteve të reja dhe atyre ku janë ndërruar nënstationet do të mbushet me ujë nga rrjeti primarë.
- Segmentet e vjetëruara të rrjetit të shpërndarjes,
- Testimet hidraulike.

3. Të dhëna të përmbledhura nga Baza e të dhënave të konsumatorëve

Në tabelën 3, kemi paraqitur të dhënat aktuale për; numrin e konsumatorëve, sipërfaqen ngrohëse dhe kapacitetin termik në varësi të llojit të konsumatorëve.

Numri aktual i konsumatorëve			
Sektori	Numri i konsumatorëve	Sipërfaqja /m ²	Kapaciteti termik /MW
Sektori Banesor	18,717.00	1,150,835.06	115.08
Sektori Biznesor	1,588.00	118,322.57	16.57
Sektori Institucional	262.00	517,677.13	72.47

TOTAL	20,567	1,786,834.76	204.12
--------------	---------------	---------------------	---------------

Tabela 3. Numri aktual i konsumatorëve, sipërfaqet respektive dhe kapaciteti termik

4. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2023/2024

Në vijim, në mënyrë tabelare kemi paraqitur të përmbledhura, të dhënat për sipërfaqen, konsumin vjetor të energjisë dhe konsumin specifik vjetor, sipas planifikimit për sezonin 2023/2024.

Planifikimi - Sezona 2023/2024			
	Sipërfaqja/m²	Konsumi vjetor i energjis/MWh	Konsumi specifik KWh/m²/vit
Konsumatorët shtëpiak	1,283,099.61	197,597.34	154
Konsumatorët Komercial dhe Institucional	650,695.76	110,253.89	169.44
Total	1,933,795.37	307,851.23	161.72

Tabela 5. Planifikimi i sipërfaqes ngrohëse, konsumit vjetor të energjisë dhe konsumit specifik për m² për vit, për sezonin 2023/2024

5. Planifikimi i kycjeve të reja gjatë sezonit 2023/2024



Prishtinë, 09/08/2023

Përgjigje në komentet e ZRRE në Aplikacionin për Tarifa të NP "Termokos"SH.A për sezonin 2023/2024

Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të veta ka filluar shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos për sezonin 2023/2024; në këtë aspekt me dt. 01 qershor 2023, NQ Termokos-it i është dërguar shkresa-njoftimi për fillimin e shqyrtimit tarifar për sezonin 2023/2024 dhe "Plani i zbatimit dhe orari". Në vijim, me dt. 02 qershor 2023 NQ Termokos-it i është dërguar Kërkesa për të dhëna dhe informata për shqyrtimin tarifar, ku janë specifikuar të dhënat, informatat dhe dokumentet që NQ Termokos duhet të dorëzoj për shqyrtimin tarifar. Me 22 qershor 2023 NQ Termokos ka dërguar përmes e-mailit aplikacionin tarifar për sezonin 2023/'24.

Në këtë dokument janë dhënë komente për përmbajtjen e aplikacionit për tarifa në përgjithësi, si dhe për përmbajtjen e secilit dokument të dërguar në kuadër të aplikacionit. Komentet kanë të bëjë me kompletimin / jo-kompletimin e aplikacionit, duke treguar se cilët dokumente janë dorëzuar dhe cilat do duheshin dorëzuar. Më tutje komentet elaborojnë në përgjithësi dhe japin udhëzime për korrektësinë e dokumenteve që përmban aplikacioni për tarifa, dhe gjithashtu, pas vlerësimit të secilit dokument të dërguar, kërkohen korrigjimet e nevojshme, informata dhe shpjegime shtesë.

Përmbajtja e Aplikacionit për Tarifa

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar në formë elektronike nga NQ Termokos përmban këto dokumente:

- 1) Pasqyrat Rregulative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2023-2024:
 - a) Pasqyra A e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;
 - b) Pasqyra B e të ardhurave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të ardhurat dhe kostot (shpenzimet);
 - c) Pasqyra C e faturimit dhe arkëtimit – të dhënat dhe informatat për sipërfaqet e ngrohjes, kapacitetet dhe sasi të energjisë termike, faturimin dhe arkëtimin e konsumatorëve;
 - d) Pasqyra D e investimeve – të dhënat dhe informata për investimet kapitale të planifikuara;
 - e) Pasqyra E teknike - të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve (supozimet për kalkulimin e kërkesës reale për ngrohje, prodhimin dhe furnizimin e ngrohjes, dhe sipërfaqja ngrohëse e parashikuar).
- 2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2022 – dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale:
 - a) Pasqyra e fitimit / humbjes (Bilanci i suksesit);
 - b) Bilanci i gjendjes;
 - c) Pasqyra e rrjedhjes së parasë; dhe
 - d) Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.



3) Të dhënat dhe informatat tjera dhe dokumentet mbështetëse:

- a) Shpalosja (zbërthimet e detajuara) e pasqyrës B;
- b) Planifikimin e prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi bazuar në parashikimin e kapaciteteve dhe sasisë së energjisë termike, si dhe të humbjeve përkatëse në rrjet; po ashtu edhe planifikimin e kostos së energjisë termike nga ko-gjenerimi.
- c) Planifikimet për sipërfaqen ngrohëse dhe konsumin e konsumatorëve për sezonin e ngrohjes 2023/24 bazuar në konsumin specifik të parallogaritur, si dhe humbjet në rrjet; gjithashtu edhe të dhënat të përmbledhura nga baza e konsumatorëve – numri i konsumatorëve, sipërfaqet ngrohëse dhe kapaciteti termik përkatës.
- d) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2023/24;
- e) Detaje dhe shpjegime për Investimet e planifikuara me vetë-financim dhe nga donacionet;
- f) Lista e nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);
- g) Lista e aseteve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e aseteve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); dhe
- h) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga ko-gjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);

Komente për Përmbajtjen e Aplikacionit të Tarifave

Aplikacioni i tarifave i dorëzuar nga NQ Termokos është mjaft i kompletuar dhe në përputhje me kërkesat e ZRRE-së. Përveç pasqyrave rregullative dhe pasqyrave financiare statusore janë dhënë edhe të dhëna, informata shtesë në formë të detajimeve (shpalosjeve) dhe shpjegime shtesë për pozicionet kryesore të kostove operative dhe kapitale (investimeve), si dhe dokumente mbështetëse.

Komentet për secilin dokument të dorëzuar në ZRRE

1) Pasqyrat Rregullative me të dhënat dhe informatat e parashikuara për sezonin e ngrohjes 2023-2024:

- a) Pasqyra 'A' e aseteve operative – të dhënat e parashikuara për asetet fikse;

Në pasqyrën A janë paraqitur asetet në vlerën fillestare (kostoja e blerjes), është dhënë zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme (vlera neto kontabël). Gjithashtu asetet janë paraqitur të ndara sipas aktiviteteve të licencuara: prodhimi dhe shpërndarja e furnizimi, si dhe asetet e përbashkëta. Nga vlera fillestare (kostoja e blerjes) në vlerë totale 79,681,141 € është zbritur zhvlerësimi i akumuluar në vlerë prej 27,566,353 €, që rezulton në vlerë neto kontabël prej 52,114,788 €. Nga analiza e aseteve ekzistuese dhe investimeve të reja të planifikuara vërehet se në vlerën totale të aseteve janë përfshirë edhe investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifar. Sidoqoftë ZRRE, do të bëjë llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) bazuar dhe në përputhje me metodologjinë tarifore duke marrë parasysh RAB fillestarë, që paraqet RAB-in e realizuar në sezonin 2022/2023, dhe Investimet e planifikuara të arsyeshme dhe të lejuara në këtë shqyrtim tarifar.

Përgjigje nga Termokos:



Parashikimi dhe analiza e aseteve për sezonin 2023-2024, ka ardhur sipas tabelave të Pasqyrës A –Pasqyra e Aseteve Operative të sezoneës 2022-2023, duke i bashkangjitur edhe pasqyrën D-G1, G2 Pasqyra e shpenzimeve të investimeve-aktuale dhe e planifikuar të sezoneës 2023-2024.

b) Pasqyra 'B' e të hyrave dhe shpenzimeve – të dhënat e parashikuara për të hyrat dhe kostot.

- Të hyrat nga shitja e ngrohjes janë paraqitur në vlerë totale prej 9,553,701 €. Nga 'Shpalosja e pasqyrës B' vërehet se këtu përfshihen të hyrat nga faturimi për shërbimin e furnizimit me ngrohje në vlerë prej 9,553,701 €, e që përputhet me faturimin e planifikuar për shërbimin e furnizimit me ngrohje në Pasqyrë 'C'. Megjithatë sa i përket të hyrave nga shitja e ngrohjes duhet theksuar se këto do të përcaktohen gjatë shqyrtimit tarifar në vlerën e lejuar që do të mbuloj kostot operative dhe ato kapitale (zhvlerësimin dhe kthimin në asete).

Ndërsa në shumën total të të hyrave (9,683,701 €) janë paraparë edhe të hyra tjera të lejuara në vlerë 130,000 €; nga shpalosja vërehet se në këtë shumë janë përfshirë të hyrat nga kyçjet, nga shërbimet në rrjetin sekondarë etj. Lidhur me këtë është vërejtur një gabim në shpalosjen e Pasqyrës 'B' – pozicioni: 'zbritjet e lejuara nga faturimi në vlerë 10,000 € nuk janë zbritur por janë shtuar në shumë e të hyrave tjera të lejuara. Duhet të rishikoni këtë pozicion dhe të bëni përmirësimin adekuat.

Përgjigje nga Termokos:

Sa i përket zbritjes së lejuar nga faturimi ne e korrigjuam këtë të gjetur ne të cilën në shpalosjen e Pasqyrës B zbritjet e lejuara kane vlerën zero dhe janë bërë korrigjimet e nevojshme në Pasqyrën B).

- Për koston e energjisë termike nga ko-gjenerimi është paraqitur shuma prej 1,586,790 €. Kjo kosto e parashikuar gjithashtu është llogaritur në: Planifikimin e koston së energjisë termike nga ko-gjenerimi (nën 'b') duke u bazuar në kapacitetet dhe sasi të planifikuara të energjisë termike nga ko-gjenerimi dhe çmimet përkatëse, ku është llogaritur e njëjta vlerë. Nga analizimi i kësaj kostoje dhe detajeve të ofruara është vërejtur se kjo kosto korrespondon me sasinë e planifikuar të energjisë termike të ekstraktuar nga ko-gjenerimi dhe çmimet aktuale përkatëse për sasi të energjisë dhe kapacitet. Gjithashtu, sa i përket planifikimeve të prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi duhet theksuar se plotësisht përputhen me planifikimet për Bilancin vjetor të energjisë 2023.
- Në Pasqyrë 'B' ju keni paraqitur koston e prodhimit vetanak të energjisë termike nga kaldajat në ngrohore respektivisht koston e lëndës djegëse (mazutit); në shpjegimet përkatëse keni dhënë llogaritjen e konsumit të mazutit për një periudhë 10 ditëshe (pika 'c') sipas rezervave të mazutit (sasia e shfrytëzueshme 695 ton) e po ashtu keni dhënë shpjegimet përkatëse se jeni në proces të marrjes së lejes mjedisore nga Ministria e Infrastrukturës Ambientit dhe Planifikimit. Lidhur me këtë duhet theksuar se për shkak të mungesës së lejes mjedisore ZRRE nuk ka mundur t'ju licençoj për aktivitetin e prodhimit



të energjisë termike nga stabilimentet (kaldajat) me mazut, e rrjedhimisht nuk mund të pranohet kostoja për një aktivitet të pa-licencuar. Për këtë duhet t'ju informojmë se lejimi i kësaj kostoje për këtë shqyrtim tarifar do të varet nga progresi në lëshimin e lejes mjedisore nga Ministria dhe pastaj licencimit nga ZRRE.

- Gjatë analizimit të kostos së planifikuar të personelit është vërejtur rritje e dukshme e kësaj kostoje në raport me realizimet e sezonit të kaluar 2022/'23. Konkretisht, për koston e personelit të angazhuar drejtpërdrejt në prodhim dhe shpërndarje ('puna direkte') është paraqitur vlera prej 1,423,643 € që paraqet një rritje prej 13.5%, ndërsa për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera është paraqitur vlera e planifikuar prej 1,458,517 €, që paraqet një rritje prej rreth 12% nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2022/23. Nëse i referohemi kostos totale të personelit, po ashtu vërehet një diferencë e konsiderueshme në mes të vlerës së kësaj kostoje në Pasqyrat Rregullative të planifikuara (totali i kostos së personelit: 2,882,160 €) dhe në Pasqyrat financiare statutores për vitin kalendarik 2022 (2,468,058 €); pra është një rritje prej mbi 400,000 € ose afërsisht 17%. Nevojitet të ofroni detaje për llogaritjen e kësaj kostoje duke dhënë numrin e punëtorëve, pagën mesatare dhe elemente tjera të kostos së personelit, si p.sh. kontributet / taksat etj. Po ashtu duhet dhënë arsyetimet përkatëse për rritjen e parashikuar.
- **Përgjigje nga Termokos:**
Sa i përket kostos së personelit, përlllogaritja e pagave për sezonin 2023-2024 është bërë sipas gjendjes së shpenzimeve të pagave për vitin 2022, ku po ashtu gjatë vitit 2023 ka ndodhur një rritje e pagave nga Bordi i Drejtoreve, e cila rritje do të ndikojë direkt tek shpenzimet e pagave për vitin 2023-2024.
Numri i punëtorëve në listen e pagave në qershor 2023 është 230 punëtorë, pagat bruto 276,994.90 euro, kontributi pensional i punëtorëve është 13,849.80euro kurse tatimi në pagë 21,060.12euro.
- Për koston e energjisë elektrike ju keni paraqitur shumën prej 835,000 € që përbëhet nga shpenzimet e energjisë elektrike në prodhim (542,750€) dhe për nënstacionet termike (292,250 €); lidhur me këtë, duhet theksuar se është parashikuar një rritje e konsiderueshme krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në sezonin e kaluar 2022/'23 (632,680€). Është e kuptueshme se me zgjerimin e bazës së konsumatorëve gjegjësisht rritjen e sipërfaqeve ngrohëse, rritet shpenzimi i energjisë elektrike e sidomos për shkak të rritjes së numrit të nënstacioneve termike, mirëpo kjo rritje duhet të shpjegohet me detajisht dhe të argumentohet mirë.
Përgjigje nga Termokos:
- Në sezonin e ardhshme, përveç nënstacioneve të reja, si konsumues të ri të energjisë elektrike, do të jenë edhe pompa e pestë e rrjetit shpërndarës me fuqi 315kW si dhe pompa e tretë e sistemit të kogjenerimit me fuqi 950kW. Pompa e rrjetit do të punojë pothuajse tërë kohën, ndërsa ajo e kogjenerimit herë pas here, varësisht prej kërkesës për energji. Dy pompat aktuale të rrjetit, me fuqi 250kW, do të zëvendësohen me të reja me fuqi 315kW. Gjithashtu si konsumues do të jenë edhe pompat e sistemit të rezervuarëve të nxehtësisë dhe shumë pajisjeve tjera shtesë. Ndikim të madh ka edhe fakti se në këtë sezonë ka edhe



ngritje të çmimit të energjisë elektrike për 15.5% krahasuar me sezonin e kaluar. Prandaj e konsiderojme të arsyeshme rritjen e planifikimit për shpenzim të energjisë elektrike.

- Për pozicionet e kostove: 'Mirëmbajtja dhe riparimet' dhe 'Materialet dhe shërbimet' ju keni paraqitur parashikimet prej 134,300 € respektivisht 90,300 €, ku në shpalosjen e pasqyrës 'B' keni dhënë mjaft të detajuar nën-komponentet e këtyre pozicioneve. Megjithatë duhet përmendur se këto vlera të planifikuara ndryshojnë dukshëm nga realizimet e sezonit të kaluar 2022/2023; sidomos rritje e madhe vërehet krahasuar me realizimin e pozicionit 'Mirëmbajtja dhe riparimet' (66,094€). Nevojitet shpjegim adekuat për këto ndryshime të këtyre kostove të planifikuara.

Përgjigje nga Termokos:

- Buxheti për këtë pozicion vazhdon të shpenzohet dhe deri në fund të periudhës raportuese, vlera e raportuar do të jetë me e madhe. E konsiderojmë të nevojshëm një buxhet të tillë pasi që në sezonin e ardhshme, për shkak të projekteve të reja, sigurisht do të paraqiten edhe kërkesa shtesë (materiale dhe pjesë për riparimin e stacionit të mazutit,etj.).
- Nën pozicionin "Shpenzimet e shitjes dhe tjera administrative" është paraqitur vlera prej 223,635 €, dhe nga detajizimi vërehet se në këtë pozicion keni përfshirë edhe nën komponentën: "shpenzimet e tatimit në fitim" në vlerën 13,192€; megjithëse kjo është shumë e vogël, duhet t'ju sqarojmë se, sipas metodologjisë tarifore, 'shpenzimet e tatimit në fitim' trajtohet dhe përfshihet në Kthimin në asete, ku përmes WACC-ut dhe vlerës së RAB (shiko Raportin e ZRRE-së për të hyrat e lejuara) përcaktohet Kthimin në asete, kështu që kjo kosto nuk i përket kostove operative. Ju lutem të konfirmoni gjetjet tona më lartë.
- **Përgjigje nga Termokos:**

Pas rishikimit të raportit, konstatuam se e gjetura qëndron ashtu siç na e keni paraqitur në koment, dhe i kemi bërë korrigjimet e nevojshme në Pasqyrën B dhe Shpalosjen e Pasqyrës B në përputhshmëri me komentin e dhënë.

- c) Pasqyra 'C' e Faturimit dhe Arkëtimit – të dhënat e parashikuara për sipërfaqen e ngrohjes, faturimin dhe arkëtimin

- o Fillimisht duhet theksuar se në Pasqyrën 'C' vlera totale e faturimit të parashikuar prej 9,553,701 €, përputhet plotësisht me vlerën e të hyrave nga shitja e ngrohjes e paraqitur në Pasqyrën 'B'. Shuma e paraqitur e faturimit përbëhet nga faturimi me matje në vlerë prej 2,908,005 € dhe faturimit pa matje (sipas sipërfaqes ngrohëse) në vlerë 6,645,696 €. Vërehet se pjesmarrja në faturimin total (si përqindje) është afërsisht e njëjtë me realizimet e sezonit të kaluar 2022/'23. Më konkretisht, vërehet se faturimi me matje është afërsisht i njëjtë me realizimin e sezonit të kaluar, përderisa ka një rritje në faturimin pa matje. Në referencë të projektit të MCC për instalimin e matësve individual



nëpër apartamente, ku planifikohet kalimi nga faturimi sipas sipërfaqes ngrohëse në faturimin e bazuar në matjen e konsumit të ngrohjes, me përfundimin e projektit do të duhej të rritej dukshëm pjesëmarrja e faturimit me matje. Planifikimet e juaja si duket nuk parashohin kalimin në faturimin me matje të këtyre konsumatorëve për këtë sezonë, që konfirmojnë edhe informatat tona nga monitorimi i projektit, se ka ngecje sidomos në implementimin e softverit për leximin dhe faturimin e bazuar në matje, sipas metodologjisë së aprovuar nga ZRRE.

Përgjigje nga Termokos:

Planifikohet të fillohet faturimi me matje nga projekti i MCC paralel si fazë testuese.

Në Pasqyrën 'C' ju keni parashikuar një sipërfaqe ngrohëse totale prej 1,933,795 m²; në këtë sipërfaqe totale, sipërfaqja e konsumatorëve me matje merr pjesë me 449,900 m² ndërsa sipërfaqja e konsumatorëve pa matje është parashikuar të jetë 1,483,895 m². Nga krahasimi me realizimin e sipërfaqes ngrohëse në fund të sezonit të kaluar shihet një rritje prej mbi 150,000 m². Kjo rritje i takon kryesisht konsumatorëve banesorë që faturohen pa matje, përderisa sipërfaqja e konsumatorëve me matje mbetet e njëjtë si në fund të sezonit të kaluar; ky fakt nuk shkon në favor të shtimit të faturimit me matje që nxit eficiencën e energjisë (kursimin e ngrohjes), dhe nevojiten shpjegime më të hollësishme për një planifikim të tillë.

- **Përgjigje nga Termokos:**

Projekti i MCC i matësve të energjisë përfundon në fund të muajit janar 2024, për këtë arsye nuk kemi planifikuar rritje të faturimit me matje, edhe pse planifikohet të bëhet faturim paralel me matje si fazë testuese dhe të bëhen krahasime për nevoja të analizave të faturimit me matje dhe krahasimit të faturimit me m² si fazë fillestare.

- Nga analiza e jonë është vërejtur se, sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është planifikuar të rritet për 150,971 m² nga sezoni i kaluar. Në shtesë ju keni dhënë në mënyrë mjaft detale planifikimet e kycjeve të reja, që në total arrijnë 419,887 m². Lidhur me kycjet e reja respektivisht rritjen e sipërfaqes ngrohëse, duhet theksuar se planifikimet e juaja reflektojnë kycjet e reja të objekteve si rrjedhojë e dendësimit dhe zgjerimit të rrjetit sipas dinamikës së realizimit të projektit të KfW që është në përfundim e sipër. Nga më sipër llogaritet se ju parashihni që rreth 36 % nga sipërfaqja e objekteve të kyqura do të shfrytëzojnë realisht ngrohjen në sezonin 2023/'24 dhe do të regjistrohen si konsumatorë. Lidhur me këtë ju udhëzojmë të analizoni sa më objektivisht mundësinë e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve në mënyrë që të jeni më real në planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse. Krahas analizës së planifikimit të sipërfaqeve ngrohëse nevojitet edhe një arsyetim për këto planifikime të sipërfaqes ngrohëse sidomos për raportin mes sipërfaqes së objekteve të kyqura dhe rritjes së planifikuar të sipërfaqes ngrohëse.



- **Përgjigje nga Termokos:**

Po është e vërtetë se planifikimi i faturimit në raport me kycjet e reja është rreth 36%, kjo për faktin se kycjet do të bëhen gradualisht nëpër muaj, sepse prej fillimit të sezonës ngrohese nuk do të kycen të gjitha objektet e planifikuara, edhe pse kur të përfundojnë të gjitha kycjet, prap rreth 50% e tyre do të jenë pasiv. Gëthmonë e marrim për bazë dhe i krahasojmë kycjet e objekteve në sezonat e kaluara.

d) Pasqyra 'D' e shpenzimeve investive – investimet kapitale të planifikuara

- Investimet e planifikuara të paraqitura nga ju janë shoqëruar me shpjegimet përkatëse për mënyrën e financimit – d.m.th. me vetë-financim dhe nga donacionet. Vërehet se pjesa dërmuese e investimeve planifikohet të financohet nga donacionet e organizatave / institucioneve ndërkombëtare (Qeveria Gjermane përmes KfW, Qeveria e SHBA-ve përmes MCC, BE-Banka Evropiane për Investime) me një pjesëmarrje të vogël të vetëfinancimit nga ndërmarrja. Shpjegimet shoqëruese gjithashtu përmbajnë detaje tjera të projekteve investive të paraqitura dhe janë paraqitur vlerat që planifikohen për periudhën njëvjeçare që përfshinë shqyrtimi tarifor, si dhe gjendjen gjegjësisht fazat aktuale përgatitore të këtyre projekteve. Duhet theksuar se projektet e planifikuara për këtë sezonë vijuese janë të përfshira edhe në planin zhvillimor afatgjatë.
- Lidhur me Projektin e MCC për instalimin matësve të ngrohjes duhet theksuar se është paraqitur vlera e mbetur e realizimit të projektit 1,692,753€, në të cilën përfshihen edhe shërbimet e konsulencës. Gjithashtu vërehet se ka pasur shtesa të vlerave monetare të investimit si në blerjen dhe instalimin e matësve dhe pajisjeve tjera ashtu edhe për shërbimet e konsulencës. Për këtë duhet rikujtuar se në shqyrtimin e kaluar tarifor ZRRE, duke marrë parasysh qështjet e ndërlidhura me pronësinë e aseteve – konkretisht obligimin ligjor për instalimin dhe pronësinë e pajisjeve matëse, ka pranuar vlerën e investimit vetëm për blerjen dhe instalimin e matësve të ngrohje prej 4,143,510 €. Gjatë monitorimit të realizimit të këtyre investimeve është konstatuar se kjo komponentë është realizuar plotësisht 4,286,579 €, pra me një mbi-realizim të vogël i cili është pranuar dhe do të korrigjohet në këtë shqyrtim tarifor. Duke marrë në konsideratë këto fakte, shtesat e projektit duhet arsyetohen dhe të detalizohen duke paraqitur vlerat përkatëse të aseteve shtesë – pra të pajisjeve matëse, Valvulave termostatike, pompave qarkulluese etj, sepse vetëm investimi shtesë dhe i arsyetuar për pajisjet matëse do të pranohet në këtë shqyrtim tarifor.
- **Përgjigje nga Termokos :**

Sa i përket vlerës prej 1,692,752.73 € e cila është paraqitur në Raportimin rregullativ është vlera e kontratës e mbetur e papërfunduar dhe përfshinë 1,384,372€ për furnizimin e pajisjeve dhe instalim, ndërsa 308,381€ janë shërbime të konsulencës. Përmirësimet janë bërë në Pasqyrën rregullative D.



- Në vijim janë paraqitur specifikuat sasi të pajisjeve dhe diferencat në vlerë monetare pas amandamentimit të fundit që i është bërë kontratës, me c' rast vlera aktuale e kontratës është 9,315,170 Euro .

Shtesat për pajisje janë:

- Në kontratën e vjetër kanë qenë të planifikuara vetëm 110 pompa ndërsa në atë të amandamentuar janë 337 në vlerë prej 346,826.39 €.
- Valvula balancuese kanë qenë të planifikuara 70 copë dhe nuk ka ndryshuar sasia e tyre, vlera e tyre është 12,526.50 €.
- Valvula për rregullim të presionit kanë qenë vetëm 105 copë dhe janë shtuar 1670 për cka edhe është rritur prej 48,970.45€ në 304,253.87€.
- Pajisjet matëse kanë qenë të planifikuara 5,100 dhe nuk ka pasë ndonjë ndryshim në sasinë e njehsorëve në vlerë prej 953,547€ dhe atë të HCA prej 64,000 copë në vlerë prej 1,651,200€.
- Pajisjet për regjistrim të shënimeve si : "data control equipment" janë shtuar prej 1100 në 2871 copë për shkak të komunikimit më të mirë të softëerit me alokator dhe me vlerë 895,417€.
- Vlera e sistemit të faturimit ka mbetur e njëjtë 735,446€.
- Vlera e Valvulave termostatike është 3,892,513€.

Megjënese ZRRE ka vendosur që mos e pranojë vlerën e Valvulave termostatike prej 3,892,513€, atëherë vlera e tërësishme e projektit që përfshinë furnizimin e pajisjeve dhe instalim është 5,422,654.91€.

Shërbimet e konsulencës detajizohen si në vijim:

- Total buxheti për shërbime konsulente është 2,370,662.73€, ndërsa të realizuara deri në kohën kur kemi raportuar kanë qenë 2,065,000€.
 - IVT si mbikqyrës deri me 29.11.2022 ka qenë 550,662.73 €, ndërsa në PIU është 420,000€.
 - Në buxhetin e konsulencës shtesa ka qenë prej 420,000€, për periudhën një vjeçare të vazhdimin të kontratës prej 1 .12.2022 deri me 1.01.2024.
-
- Sa i përket 2 projekteve tjera të paraqitura: Projekti i KfW-EU-EBRD Solar4Kosova dhe Projekti i EU-EIB për dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit, duhet marr parasysh



vonesat që kanë ndodhur në të kaluarën në realizimin e këtyre projekteve, dhe me qëllim të përcaktimit sa më real të Bazës së Rregulluar të Aseteve, nevojitet një qasje sa më realiste në planifikimin e realizimit të këtyre projekteve.

- **Përgjigje nga Termokos :**

Projekti "Solar4Kosova" është duke u sqarur, dhe deri në fund të muajit shtator do të kemi kompaninë konsulente për këtë projekt. Është shumë reale që në pjesën e dytë të vitit 2024 do të kemi të zgjedhur edhe kontraktorët për projekt. Në këtë rast pagesat për paradhënie dhe për punë të realizuar deri në fund të vitit janë të pashmangshme. Sa i përket projektit për dyfishim të kapaciteteve, kompania konsulente ka filluar përpilimin e dizajnit konceptual. Një skenar optimist jep me kupto se edhe në këtë projekt, në vitin në vijim do të kemi lëvizje konkrete. Prandaj planifikimi i një buxheti, ashtu siç është paraqitur në raport, është i domosdoshëm.

- Sa i përket investimeve me vetë-financim keni parashikuar një vlerë mjaft të madhe prej 11,828,139 €, ku në këtë vlerë përfshihet vlera e bashkëfinancimit të projekteve të donatorëve prej 8,254,139€.

- **Përgjigje nga Termokos :**

- a) Lidhur me vlerat e bashkëfinancimit të projekteve të donatorëve, vlera më e madhe që planifikohet të financohet me mjete vetanake të Termokosit, i përket projektit të KfW që tashmë është në përfundim të realizimit. Shuma e mjeteve prej 6,754,139.00 euro për dy pakot e projektit (T-1 dhe T-2), detyrimisht duhet të paguhet nga NP "Termokos" SH. A. si bashkëfinancim, për shkak se fondet nga donacionet për këtë projekt kanë mbaruar dhe nuk është gjetur ndonjë donator tjetër që do të merrte obligim mbulimin e kësaj shume. Ky bashkëfinancim është dedikuar për mbulimin e kostos për zgjerimin e rrjetit kryesisht në lagjet Mati 1 dhe Arbëria, për arsye se pas projektit fillestarë, ka pasur ndërtime të objektetve të reja në pjesën ku ka kaluar rrjeti, e të cilat ka qenë e pamundur të anashkalohen.
- b) Si bashkëfinancues në Projektin e MCC për instalimin e matësve të energjisë termike, Termokos për vitin 2023 ka ndarë mjetet prej 1,000,000.00 euro, si fonde shtesë për zgjerim të projektit për vendosjen e matësve të energjisë termike, me qëllim që arritjes së synimit që të gjithë konsumatorët e Termokosit të përfshihen në sistemin e faturimit me matje.
- c) Sa i përket Projektit për dyfishim të kapaciteteve termike në 280 MW, Termokosi si bashkëfinancues i këtij projekti, ka zotuar mjetet prej 2.5 milion euro (prej viteve 2021-2025 me nga 0.5mil. euro për vit). Gjithashtu, duke u bazuar në rrjedhën e proceseve për sa i



përket progresit për këtë projekt, vlerësojmë që në vitin në vijim do të kemi lëvizje konkrete, prandaj planifikimi i shumës prej 0.5 mil euro, është i domosdoshëm.

- Në vlerën e mbetur prej 3,574,000€ përfshihen investimet në pajisjet e prodhimit (731,000 €), në rrjetin e shpërndarjes (340,000 €) dhe 2,503,000 € të kategorizuara në 'investimet në administratë dhe shërbimet e përbashkëta'; në këtë kategori investimi kryesor prej 2,443,000 € planifikohet për ndërtimin e objektit administrativ e drejtorisë. Lidhur me këtë duhet theksuar se në monitorimin e realizimeve të periudhës (sezoni) të kaluar është konstatuar se investimet me vetë-financim janë realizuar në nivelin 62% (nga 2,730,500 € të lejuara janë realizuar vetëm 1,681,172€).

➤ **Përgjigje nga Termokos :**

Për mos realizimin e vlerave të planifikuara në tërësi gjatë vitit të kaluar, ka ndikuar shumë fakti që një numër i konsiderueshëm i kontratave nuk është realizuar për shkak të procedurave të prokurimit.

Investimet në Departamentin e Distributimit :

Për shkak të rritjes së vëllimit të punimeve në terren (zgjerimit të rrjetit në lagje të reja, riparimit të rrjetit, etj.), shprehet nevoja e furnizimit me tubacione, pajisje dhe makineri adekuate, gjithashtu edhe ndikim të madh ka ngritja e kostos së materialeve në tregun global, janë paraparë investime në vlerën prej 340,000 €.

Investimet në Departamentin e Prodhimit/koogjenerimit :

1. Furnizim me fletëza dhe diktuna për këmbyes të nxehtësisë 50MW me montim – është planifikuar për herë të parë, pasi që fletëzat e këmbyesve të nxehtësisë në HRS nuk janë ndërruar asnjëherë. Aktualisht furnizimi me këtë artikull është në procedurë të prokurimit.

2. Elektromotor me pompë e kondenzatit me aksesori përcjellës dhe shërbim për funksionim- paraqet furnizimin dhe montimin e elektromotorëve, të cilët do të montohen në HES. Megenëse, aktualisht është vetëm një pompë për të dy kondenzatorët e nxehtësisë, gjë që duhet secili kondenzator i nxehtësisë të ketë nga një pompë rezerve.

3. Instrumente për sistemin automatik -pjesë rezervë dhe Frekuentor për pompat - Për modulet e paraqitura nevojitet të ketë pjesë rezervë .

4. Elektromotorët e pompave- janë të dedikuar për stacionin e Kodrës së Diellit dhe nevojitet të kemi elektomotor rezervë, për shkak që elektromotorët aktual janë të instaluar që nga viti 2004 , dhe shprehet nevoja që të kemi elektomotor rezervë.



5. Gjithashtu edhe paisjet tjera të planifikuara janë të nevojshme për shkak se ndikojnë në ngritjen e kualitetit të furnizimit me energji termike dhe mundësojnë furnizim të qëndrueshëm me energji termike.

- Sa i përket konkretisht investimit të lejuar për ndërtimin e objektit të administratës, prej 482,000 € nuk është realizuar fare; po ashtu në vazhdimësi nga sezoni në sezonë vërehet rritja e vlerës së parashikuar për ndërtimin të objektit nga vlera fillestare që tani ka arritur në 2,443,000€. Kjo rritje nuk është shpjeguar / arsyetuar / argumentuar mjaftueshëm, ashtu që këto planifikime të arsyetohen dhe të pranohen në shqyrtimin tarifor.

- **Përgjigje nga Termokos:**

Buxheti i ndarë për realizimin e projektit për ndërtimin e objektit të ri administrativ, fillimisht ka qenë 2.2milion euro, mirëpo pas shpalljes së tenderit "Ndërtimi i objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse", oferta me çmimin më të lirë ka qenë në vlerë rreth 2,433,000.00 euro. Gjatë procesit të tenderimit Autoriteti Kontraktues- NP"Termokos"sh.a, ka pranuar 3 oferta, prej të cilave 2 oferta kanë qenë brenda buxhetit të ndarë nga Autoriteti Kontraktues (AK), mirëpo kanë qenë të papërgjegjshme, ndërsa oferta e tretë ka qenë më e lartë se vlera e ndarë nga AK, me ç'rast AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Pas kësaj, AK ka pranuar ankesë nga OE për këtë aktivitet të prokurimit, prandaj AK ka dorëzuar kërkesën për interpretim ligjor pranë KRPP-së lidhur me ofertën që ka tejkalluar vlerën e mjeteve të ndara nga AK. Më pas kemi pranuar përgjigje nga KRPP-ja se mund të rritet vlera e mjeteve të ndara/alokuara nga AK përmes aprovimit nga ZKA dhe ZKF. Prandaj, NP "Termokos"sh.a,ka alokuar mjete shtesë në vlerë prej 234,000.00 euro për të mbuluar vlerën e projektit. Shuma e mjeteve të ndara për këtë projekt përfshinë periudhën buxhetore 2023-2024.

- Për këtë projekt është nënshkruar kontrata me datë 28.07.2023 me grupin e operatorëve; "Limit Projekt Sh.p.k., Delta projekt Sh.p.k. dhe Rinesa Sh.p.k.-Gllgovc. Vlera e kontratës është 2,433,753.60 euro. Kontrata hynë në fuqi me datë 08.08.2023 ndërsa përfundon me datë 08.02.2025, dhe punimet duhet të fillojnë menjëherë pas hyrjes në fuqi të kontratës. Projekti zgjatë 18 muaj.

Prandaj planifikimi i vlerave financiare përkatëse, ashtu siç janë paragjitur në raport, është i domosdoshëm.



- e) Pasqyra teknike 'E' –të dhënat e parashikuara për bilancin e energjisë termike, si dhe të dhënat teknike dhe të konsumatorëve.

Nga analiza e kësaj pasqyre është vërejtur paraqitje e saktë e të dhënave dhe në përputhje dhe të dhënat përkatëse të dokumenteve dhe shpjegimeve mbështetëse; nuk ka ndonjë koment për këtë pasqyrë.

2) Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat financiare statutores për vitin 2022

Pasqyrat financiare statutores për vitin 2022: "Pasqyra e pozitës financiare", "Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse", "Pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet", janë të përfshira në Raportin e auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe të aprovuara nga menaxhmenti i ndërmarrjes dhe të nënshkruara nga zyrtarët kompetentë. Nuk ka ndonjë koment tjetër shtesë.

3) Dokumentet tjera mbështetëse:

3.1) Investimet e reja

Planifikimi i investimeve – të dhëna dhe informata për investimet kapitale të planifikuara në periudhën një vjeçare që përfshin sezonin 2023/2024. Në dokument janë dhënë ndarazi investimet e planifikuara me financim vetanak të ndara sipas departamenteve në vlerë totale prej 11,828,139 € ku shuma prej 8,254,139€ janë bashkëfinancim për projektet e donatorëve; investimet nga donacionet në vlerë totale 15,692,753 €. Këto japin vlerën totale të investimeve të reja për periudhën në fjalë në vlerë 27,520,892 €; këto vlera të paraqitura përputhen me vlerat përkatëse të paraqitura në Pasqyrën 'D' të investimeve. Gjithashtu janë dhënë detaje, përshkrime dhe shpjegime përkatëse lidhur projektet kryesore investive të financuara nga donatorët si KfW dhe MCC dhe EU-EIB, si dhe për projektet me vetëfinancim dhe bashkëfinancim. Investimet e planifikuara të paraqitura në përgjithësi janë në përputhje me Planin Zhvillimorë Afatgjatë.

- Investimet e reja me vetëfinancim

Në këtë dokument janë paraqitur detaje për investimet e reja në:

- Prodhimin e energjisë termike në vlerë totale 731,000€, ku kryesisht përfshihen pajisje për stacionet e ekstraktimit dhe pranimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi, si dhe pajisje tjera si pompa, këmbyes e valvola.
- Shpërndarjen e energjisë termike në vlerë totale 340,000 €, ku përfshihet tubacione e fittingje dhe pajisje tjera të ndërlidhura, matës të ngrohjes, pompa qarkulluese, pajisje të sistemit të mbajtjes së shtypjes, automjete të terrenit e eskavator, etj.
- Në Investimet në administratë e shërbime të përbashkëta, ndër tjera, është planifikuar edhe ndërtimi i ndërtesës të zyrës qendrore administrative të NQ Termokos në vlerë prej 2,433,000 € , për të cilën është dhënë shpjegimi ku tregohet se pas vendimit të OSHP-së ky projekt është ritenderuar në mars 2023 dhe aktualisht është fazën e vlerësimit. Siç u përmend më lartë vlera e parashikuar e këtij investimi ka shënuar rritje në vazhdimësi nga sezoni në sezonë dhe kjo nuk është arsyetuar me argumente dhe fakte bindëse. Po ashtu lidhur me këtë investim duhet theksuar se ky projekt është paraqitur si planifikim edhe në



shqyrtimin e kaluar tarifor, porse ende nuk ka filluar realizimi i tij për shkak të vonesave të ndërlidhura me procedurat e prokurimit / tenderimit. Nuk është paraqitur asnjë shpjegim shtesë lidhur me gjasat e përfundimit të këtyre procedurave në kuptim të afateve kohore. Me qëllim të planifikimit realist do duhej që ky investim të arsyetohet me dëshmi konkrete për progresin në kryerjen e këtyre procedurave të tenderimit dhe gjithashtu të reflektoj edhe në paraqitjen vlerave financiare përkatëse.

- Për investimet me bashkëfinancim të projekteve të donatorëve janë paraqitur mjaft detaje për komponentet e bashkëfinancimit: i) Për projektin aktual të KfW: Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrejtit të shpërndarjes dhe nënstacione të reja është vlera 6,754,139€; ii) për projektin E MCC instalimi i matëve të ngrohjes vlera e bashkëfinancimit është planifikuar të jetë 1 mil. €; dhe për projektin e EU-EIB të dyfishimit të kapaciteteve të kogjenerimit është planifikuar vlera e bashkëfinancimit prej 500,000 €.

- **Përgjigje nga Termokos:**

Vlejnë sqarimet e dhëna më lartë.

Për investimet e reja me vetëfinancim dhe bashkë-financim janë dhënë vërejtjet / komentet për Pasqyrën 'D'(nën pikën 'd'), të cilat vlejnë vlejnë edhe këtu.

- **Investimet e reja nga donacionet**

Këto investime janë kategorizuar sipas projekteve dhe donatorëve përkatës (Qeveria Gjermane përmes KfW, Qeveria e SHBA-së përmes MCC dhe EU-EIB), ku janë paraqitur detajet teknike dhe financiare për këto projekte:

- **Projekti i MCC-MFK Instalimi i pajisjeve matëse të ngrohjes qendrore;** për këtë projekt është paraqitur vlera prej 1,692,753 € si donacion që planifikohet të realizohet në periudhën e ardhshme të shqyrtimit tarifor. Nga të dhënat për projektin vërehet se ka pasur shtesa në investime e gjithashtu vlera e planifikuar përfshinë edhe shërbimet e konsulencës. Lidhur me këtë duhet ritheksuar se në shqyrtimin e kaluar tarifor ZRRE, duke marrë parasysh qështjet e ndërlidhura me pronësinë e aseteve – konkretisht obligimin ligjor për instalimin dhe pronësinë e pajisjeve matëse, ka pranuar vlerën e investimit vetëm për blerjen dhe instalimin e matëve të ngrohje prej 4,143,510 €. Gjatë monitorimit të realizimit të këtyre investimeve është konstatuar se kjo komponentë është realizuar plotësisht në vlerën 4,286,579 €, pra me një mbi-realizim të vogël i cili është pranuar dhe do të korrigjohet në këtë shqyrtim tarifor. Duke marrë në konsideratë këto fakte, shtesat e projektit duhet arsyetohen dhe të detalizohen duke paraqitur vlerat përkatëse të aseteve shtesë – pra të pajisjeve matëse, Valvulave termostatike, pompave garkulluese etj, sepse vetëm investimi shtesë dhe i arsyetuar për pajisjet matëse do të pranohet në këtë shqyrtim tarifor.

- **Përgjigje nga Termokos :**

Vlejnë sqarimet e dhëna më lartë përkitazi me këtë projekt.

- **Projekti i KfW-EU-EBRD 'Solar4Kosova';** ky është një projekt që është në përgatitje e sipër që parashihet në vlerë totale rreth 80.5 mil €, i cili parashihet të financohet nga donatorë dhe Institucione tjera financiare si kombinim kredi-donacion-bashkëfinancim:



Donacion EU/Komisionin Evropian 22.5 mil €; Donacion KfW 10 mil €; Kredi EBRD 22 mil €; Kredi KfW 21.6 mil €; Bashkëfinancim Termokos 4.4 mil €. Për periudhën që mbulon shqyrtimi tarifar NQ Termokos ka planifikuar shumën prej 10 mil € për fillimin e punimeve. Duke ditur se ky projekt është në fazën pregaditore ku ndër tjera përfshihet edhe përzgjedhja e firmës konsulente që ndër detyrat ka edhe përgatitjen e specifikacionit të tenderit për përzgjedhjen e operatorit për ekzekutim të punimeve; kështu procedura normalisht marrin një kohë të konsiderueshme prandaj udhëzohet që NQ Termokos të ketë një qasje sa më realiste në planifikimin e realizimit të këtyre projekteve përfshirë këtu edhe periudhat e implementimit.

- **Përgjigje nga Termokos :**

Projekti "Solar4Kosova" është duke u sqaruar, dhe deri në fund të muajit shtator do të kemi kompaninë konsulente për këtë projekt. Është shumë reale që në pjesën e dytë të vitit 2024 do të kemi të zgjedhur edhe kontraktorët për projekt. Në këtë rast pagesat për paradhënie dhe për punë të realizuar deri në fund të vitit janë të pashmangshme.

- **Projekti i EU-EIB për dyfishimin e kapacitetit të ko-gjenerimit;** ky është gjithashtu një projekt në përgatitje e sipër në vlerën total të parashikuar rreth 50 mil €, i cili parashihet të financohet nga donatorë dhe institucione financiare të ndryshme si kombinim kredi-donacion-bashkëfinancim: Grant nga Komisioni Evropian 17.5 mil €; Grant 1.5 mil € nga EIB; Donacion nga Komuna e Prishtinës 5 mil €; bashkëfinancim NQ Termokos 2.5 mil €; dhe pjesa e mbetur prej rreth 23.5 mil € kredi nga EIB dhe potencialisht ndonjë donatorë tjetër ndërkombëtarë. Për këtë projekt ju keni paraqitur vlerën prej 4 mil. €, që planifikohet për periudhën e shqyrtimit tarifar; kjo shumë dedikohet për studime dhe raporte dhe projektim, si dhe për fillim të realizimit të projektit. Bazuar në informatat e disponueshme ky projekt është ende në fazën studimore dhe përgatitore; për këtë arsye rekomandohet një qasje realiste në planifikim përfshirë këtu edhe planifikimet për periudhat e implementimit, që sipas vlerësime tona fillestare janë shumë të avancuara.

- **Përgjigje nga Termokos :**

Sa i përket projektit për dyfishim të kapaciteteve, kompania konsulente ka filluar përpilimin e dizajnit konceptual. Një skenar optimist jep me kuptim se edhe në këtë projekt, në vitin në vijim do të kemi lëvizje konkrete. Prandaj planifikimi i një buxheti, ashtu siç është paraqitur në raport, është i domosdoshëm.

Po ashtu vërejtjet / komentet tjera të bëra për Pasqyrën 'D' për investimet nga donacionet (nën pikën 'd') vlejné edhe këtu.

3.2) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2023/2024

- Janë paraqitur të dhëna mjaft detaje në formë tabelare për planifikimet e kyçjeve të reja që përmbajnë të dhënat për vendndodhjen (lokacionin) e objekteve, numrin e banesave dhe njësisë afariste dhe sipërfaqet ngrohëse përkatëse. Sipas përshkrimit tabelarë



vërehet se sipërfaqja totale e objekteve - kyçjeve të reja të planifikuara është 419,887m². Lidhur me këtë duhet theksuar se ky planifikim reflekton dendësimin dhe zgjerimin e rrjetit sipas dinamikës së realizimit të projektit të KfW që është në përfundim e sipër. Përderisa sipërfaqja e përgjithshme e ngrohjes është planifikuar të rritet për 150,971 m² nga sezoni i kaluar. Pra llogaritet se ju parashihni që rreth 36 % nga sipërfaqja e objekteve të kyqura do të shfrytëzojnë realisht ngrohjen në sezonin 2023/'24 dhe do të regjistrohen si konsumatorë. Lidhur me këtë ju udhëzojmë të analizoni sa më objektivisht mundësinë e kontraktimit me konsumatorët banues të atyre objekteve në mënyrë që të jeni më real në planifikimet e sipërfaqeve ngrohëse. Krahas analizës së planifikimit të sipërfaqeve ngrohëse nevojitet edhe një arsyetim për këto planifikime të sipërfaqes ngrohëse sidomos për raportin mes sipërfaqes së objekteve të kyçura dhe rritjes së planifikuar të sipërfaqes ngrohëse.

- **Përgjigje nga Termokos :**

Planifikimi i faturimit në raport me kyçjet e reja është rreth 36%, kjo për faktin se kyçjet do të bëhen gradualisht nëpër muaj, sepse në fillim të sezonës ngrohëse nuk do të kyçen të gjitha objektet e planifikuara edhe pse kur të përfundojnë të gjitha kyçjet, prap rreth 50% e tyre do të jenë pasive. Gjithmonë e marrim për bazë dhe i krahasojmë kyçjet e objekteve në sezonat e kaluara.

3.3) Planifikimi i prodhimit të energjisë termike, furnizimit dhe humbjeve në rrjet

- Prodhimi i energjisë termike është parashikuar të jetë kryesisht nga stabilimentet e kogjenerimit në TC Kosova B, ku detajet janë paraqitur në formë tabelare për prodhimin e energjisë termike nga kogjenerimi bazuar në Bilancin e energjisë dhe në planifikimet përkatëse për pjesën e dytë të sezonin (janar – prill 2023).
- Sa i përket vlerësimeve për furnizimin dhe humbjet në rrjet, duhet pasur parasysh dhe duhet bazuar në planifikimet përkatëse në Bilancet vjetore dhe afatgjata të energjisë termike.

- **Përgjigje nga Termokos :**

Planifikimi për energji është bërë bazuar në realizimin e sezonës paraprake dhe vlerësimit të kërkesave për sezonën e ardhshme. Në këtë rast është marrë parasysh zgjerimi dhe dendësifikimi i rrjetit dhe numri i konsumatorëve të rinjë që do të hynë në sistem në sezonën në vazhdim.

Sa i përket humbjeve, si referencë është marrë riparimi i rrjetit dhe zgjerimi i saj. Intenca e zvogëlimit të humbjeve, energjisë dhe ujit, mbetet imperativ i Termokosit.

Shënim:



Termokos

Ngrohja e qytetit

Prishtinë, 08/09/2023

Raportet dhe dokumentacionet plotësuese lidhur me kërkesën e ZRRE për projektet zhvillimore të NP "Termokos" SH.A të paraqitura në Aplikacionin për Tarifa të ngrohjes për sezonin 2023/2024

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të procesit të shqyrtimit e tarifave të energjisë termike për NP "Termokos" SH.A për sezonin 2023/2024, me dt. 29 gusht 2023, ka kërkuar informacione dhe dokumentacione shtesë lidhur me projektet zhvillimore të NP "Termokos" SH.A të paraqitura në Aplikacionin tarifor për sezonin 2023/2024. Bazuar në kërkesën e lartëcekur, ju ofrojmë këto të dhëna dhe dokumentacione :

a) Sa i përket projekteve "Solar4 Kosova II "dhe projektit "Dyfishimi i kapaciteteve prodhuese termike", me datë 06.09.2023 përmes USB ua kemi dorëzuar këto dokumente :

- Për projektin "Solar4 Kosova II ":

1. Studimi i fizibilitetit,
2. Studimi i ndikimit në mjedis dhe social.

- Për projektin "Dyfishimi i kapaciteteve prodhuese termike" :

1. Plani i dekarbonizimit ,

2. Marrëveshjen në mes Bankës Europiane për Investime , Ministrisë së Financave dhe NP "Termokos "sh. A.

b) Informacionet lidhur me projektin për zgjerim dhe rehabilitim të rrjetit të ngrohjes – projekti i KfW.

Projekti në total ka mbërri vlerën rreth 19 mil. Euro, ku si donacion janë mjete të Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë së Luksemburgut përmes KfW-se në vlerë prej 10,616,143.64€, kurse pjesa tjetër mbulohet nga fondet vetanake të NP "Termokos" SH.A si bashkëfinancues i projektit.

Kosto e punëve shtesë në rehabilitim është 619,443.53€

Kosto e punëve shtesë në densifikim është 236,844.18€

Të gjitha ndryshimet janë bërë në bazë të rregullave të FIDIKUT, në bazë të të cilave janë nënshkruar kontratat. Të gjitha ndryshimet për punët shtesë i kanë konstatu ekspertët e konsulencës në bashkëpunim me ekspertët e Termokosit, e të cilat janë aprovuar nga KFW-ja.

Vendimarrja për punët shtesë dhe dokumentacionet përcjellesë janë të evidentuara dhe faktuara në minuta të takimeve të rregullta javore, mujore dhe në raporte të rregullta periodike të projekteve, në të cilat marrin pjesë të gjitha palët e përfshira në projekt duke filluar nga KFË, Termokosi, Konsulenca dhe Kontraktoret.

Shih listën e punëve shtesë në rehabilitim:

Connection for Government buiding - Ex Rilindja
Near Banka qendrore and Grand hotel
Stacioni policor 92
Airport Building
Connection from ex old store to main government building
Swis diamond hotel till pension building
Qamil Hoxha street
Behind ambulance and till connection for Qafa buildings
Near Avalla building
Behind University rektorat
Bibloteka e madhe kalimi I rruges - poz. I shtuar me kerkese TER
Pipe near the chathedral going to Primary school Faik Konica
Connection from main pipe going inside the Flamurtari parking lot, PRAPA SANTESE
Ambulanta familjare Ulpiane DAE 17
Kurrizi
Connection from Ex restaurant Dubrovniku to soladiriteti building 2/10
Qeshmja e bardhe
Connection for RR/B te posta e re
Connection for RR/B 1/3

Near Marko Polo
Connection near Bashksia lokale Dardani
Connection thru Bast Trade
Green part Dardania, ndertesat e kaltra parking
Connection near Musk - dardania Novi dom
Connection below the YU program building
Connection for U1 building
Connection near filosofic faculty going to Albanologic Institut
Connection from Galery of arts building to behind of Aktash buildings(passing the street Agim Ramadani)
Connection for student city
Connection near Hystory institute
trade center sunny hill
Zona qender, Ismail Qemali, Sunny hill
Connection kinder garden Dardania
Parking above the road of Termokos 1/5, 1/7 parking
Connection near kinder garden ULP
Connection from shaft hotel Baci to hospital heating plant
Connection behind D-9
D 6 - Connection till D-7,
Eulex building
Connection for RR B
Hospital Center - Stomatologji
Hospital Center - klinika e syrit
Zona perindimore perballe rexhep selimit
Bregu I diellit zona lindje
Bregu I diellit furnizimi per MAXI RR. B
Prapa Bill Klinton
Te Lulishtja Centre

Sqarim: Disa nga punët shtesë, me investim me të madh, përtej planifikimit fillestarë të projektit janë.

Për T-2,

1. VO2-Zgjerimi i rrjetit në lagjen Mati 1 – rr. "Muharrem Fejza" për më shumë se 30 objekte nga parashikimi fillestarë;
2. VO1-Rritja e diametrit të gypit furnizues për këtë lagje, pas rritjes së numrit të objekteve, nga DN250 në DN350;
3. VO3-Rritja e gypit DN400 në DN450 në rrjetin furnizues të Bregut të Diellit (nga puseja të hotel Baci deri të Ngrohtorja e Spitalit).
4. VO4-Rritja e diametrit dhe gjatësisë së gypit magjstral për lagjen Arbëria.

Për T-1,

VO2-zgjatje e gypave në nënstacione. Sipas kontratës, kontraktori ka obligim instalimin e 10m trasë nga pika ku depertojnë gypat në objekt e deri te nënstacioni. Meqenëse, për shkak të problemeve me hapësira të nënstacioneve në objekte, shumica e nënstacioneve janë në distancë 20 deri në 50m largesi nga pika depërtuese e gypave. Ky ndryshim është dashur të kompenzohet.

Çdo kosto e cila e tejkalojnë fondin e KFW-se ku përfshihen fondet e Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë së Luksemburgut, duhet të mbulohet me fonde vetanake.

Këtë e parasheh marrëveshja tripaleshe në mes KFW, Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.a(Projekti-Agjencia Ekzekutive) e nënshkruar me 29 mars 2018 në mes palëve të lartëcekura.

Lagjet e kyçura dhe ato të cilat do të kyqen nga ky projekt janë si në tab nr-1.

Projekti per zgjerim dhe rehabilitim te rrjetit - KFW

Tab. 1.Lagjet e kyçura dhe objektet të cilat planifikohet të kyçen

ZGJERIM				
	Të kyçura		Planifikohen të kyçen	
Lagjja	Konsumatorët e kyçur deri tani nga ky projekt	Sipërfaqja e kyçur deri tani nga ky projekt	Konsumatorët që do të kyçen - mbetja	Sipërfaqja që do të kyçet- mbetja
Mati 1	6441	435,389.93	2454	159,466.00
Ulpianë	243	13,028.95		
Qendër			1710	111,174.80
Arbëri			3410	221,645.50
Totali	6684	448,418.88	7574	492,286.30

DENSIFIKIM				
Qendër			882	57,306.30
Dardani			178	11,564.35
Kodra e diellit			12	756.00
Ulpianë			268	17,440.50
Totali			1340	87,067.15

TOTALI ZGJERIM-DENSIFIKIM	6684	448,418.88	8914	579,353.45
----------------------------------	-------------	-------------------	-------------	-------------------

Planifikimi i kyçjeve në zgjerim dhe densifikim				
--	--	--	--	--

Rajoni	Slp.m²	Nr i konsumatoreve
Qendër		

	111,174.80	1,710
Arbëri	221,645.50	3,410
Densifikim	87,067.15	1,340
	419,887.45	6,460

C) Ndërsa, sa i përket realizimit të projektit "Ndërtimi i objektit të ri administrativ, dhe renovimi i hapësirave përcjellëse", ju informojmë se:

- Për këtë projekt është nënshkruar kontrata me datë 28.07.2023 me grupin e operatorëve; "Limit Projekt Sh.p.k., Delta projekt Sh.p.k. dhe Rinesa Sh.p.k.- Glogovc. Vlera e kontratës është 2,433,753.60 euro. Kontrata ka hyrë në fuqi me datë 08.08.2023, ndërsa përfundon me datë 08.02.2025. Projekti zgjatë 18 muaj.
- Punimet për realizimin e këtij projekti kanë filluar menjëherë pas hyrjes në fuqi të kontratës. Deri më tani janë kryer punimet për lirin e hapësirës për ndërtimin e objektit të ri, me ç'rast janë larguar dy rezervuarë të mazutit, është rrënuar objekti që ka shërbyer si punëtori e Dep. të prodhimit dhe stacioi për ngohjen e mazutit (i cili duhet të vendoset diku tjetër).
- Aktualisht është duke u bërë largimi i dheut nga vendi ku do të fillojë ndërtimi i objektit.
- Informatat kryesor e lidhur me kontratën për ndërtimin e objektit janë të bashkangjitura në e-mail.

KONTRATË

Numri i kontratës¹: NP Termokos.shë-23-1791-5-1-1/C163

NP "TERMOKOS" Sh.a., (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA - CCD SH.P.K.; Rimesa SH.P.K.; ILEAA - GR SH.P.K., Skenderbeu Q.Zej.E-3-5, „ Glllogoc, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shëmtues me poshtë:

Ndërtim i objektit të ri administrativ dhe renovim i hapësirave përcjellëse të NP "TERMOKOS" Sh.a Rëndësi me numër identifikues: NP Termokos.shë-23-1791-5-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Ndërtim i objektit të ri administrativ dhe renovim i hapësirave përcjellëse të NP "TERMOKOS" Sh.a sipas specifikave teknike të kërkuara në dorë të tenderit , plani ideor dhe projektit detaj. dhe në bazë të Ligjit të prokurimit publik Nr.04 -L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 08.08.2023 dhe përfundon deri me 08.02.2025

1.3 Afati kohor për përfundimin e projektit ; Ndërtim i objektit të ri administrativ dhe renovim i hapësirave përcjellëse të NP "TERMOKOS" Sh.a do të jetë 18 muaj nga koha e lëshimit të urdhërimit nga ana e Autoritetit Kontraktues.

1.4 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë DDP

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 2,433,753.60 €; [Dy/mijë/tre/tre/shtatë/pesë/tre] 0/100 Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

¹ Ju kërkohet referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e furnimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me detyrën.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

L.Bj
1